

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE TË PASTRUESVE TË AJRIT BOSCH

Në rast të paraqitjes së defekteve brenda afatit të garancisë, dhënësi i garancisë do të zgjidhë këto defekte të pajisjes së klientit duke zëvendësuar komplet produktin në shitoret ku është blerë pajisja.

Ju lutemi që para se të dërgoni pajisjen e prishur tek shitësi, lexoni kushtet e përgjithshme të garancisë të dhëna në librezën e garancisë. Me qëllim të zvogëlimit të humbjes së kohës dhe parandalimit e shqetësimit të klientit kur defekti është pasojë e përdorimit të parregullt, ju lutemi që para se të shkoni në shitore, të kontrolloni në tabelën më poshtë nëse është e mundur që problemin e paraqitur ta zgjidhni duke aplikuar ndonjë nga zgjidhjet e propozuara.

Për të gjitha pyetjet shtesë na kontaktoni në info@aparatiko.mk

PROBLEMI	SHKAKU	ZGJIDHJA
Pajisja nuk mund të ndizet, as nuk reagon në shtypje të tastierit në automatik.	Furnizimi me rrymë.	<ul style="list-style-type: none">• Futeni pajisjen në rrymë.• Kontrolloni nëse kabli i furnizimit me rrymë është dëmtuar. Nëse është dëmtuar, menjëherë ndalojeni përdorimin e pajisjes dhe kontaktoni shitësin.• Provoni të futni pajisjen në një prizë tjetër në dhomë.
Nuk mund të aktivizoj funksionet në pajisjen time.	Pajisja është në modalitetin standby.	Nëse pajisja juaj është e lidhur në prizë, por butoni i ndezjes nuk është shtypur, pajisja do të jetë në modalitetin e gatishmërisë. Thjesht shtypni butonin e energjisë për të ndezur pajisjen
A mund ta lidh pajisjen në WiFi?	WiFi	Jo, këtë pajisje nuk mund ta lidhni në WiFi.
A mund ta pastroj vet filtrin në pajisjen time?	Info	Ju lutemi ndiqni procedurën e pastrimit dhe udhëzimet në manualin e përdorimit për të pastruar sipërfaqen e filtrit me një leckë të lagur ose një fshesë me korrent. Kur në ekranin e pajisjes shfaqet një paralajmërim për zëvendësimin e filtrit, zëvendësojeni atë. Filtri nuk duhet të lahet kurrë me ujë.

Pajisja nuk punon siç duhet	Filtri është i ndotur apo i bllokuar.	Paralajmërimi i zëvendësimit të filtrit është aktiv në ekran, por ju nuk e keni zëvendësuar ende filtrin. Si rezultat, pajisja nuk e pastron më ajrin me aq efikasitet si më parë. Kështu që zëvendësojeni filtrin dhe shtypni gjatë butonin e filtrit për të rivendosur numëruesin e jetëgjatësisë së filtrit.
Qarkullimi i ajrit që del nga pajisja është shumë më i dobët se më parë	Filtri është i ndotur ose i bllokuar.	Sipërfaqja e filtrit është e ndotur. Pastrojeni sipërfaqen e filtrit (shihni udhëzimet brenda manualit të përdorimit).
	Shpejtësia e ulët e ventilatorit	<ul style="list-style-type: none"> • Klikoni ikonën e ventilatorit për të ndryshuar shpejtësinë e ventilatorit; • Cilësia e ajrit është e mirë, dhe ventilatori funksionon në modalitetin automatik, pajisja vetë përcakton rrjedhën e ajrit në dalje.
Cilësia e ajrit nuk përmirësohet edhe pse pajisja funksionon për një kohë të gjatë	Filtri është i ndotur ose i bllokuar.	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurohuni që të keni hequr paketimin plastik në të cilin është furnizuar filtri origjinal • Filtri nuk futet në pajisje. Sigurohuni që filtri të jetë montuar siç duhet brenda pajisjes. • Filtri ka plotësuar kohëzgjatjen e vet të punës. Zëvendësojeni me një të re. • Filtri është i bllokuar dhe kërkon mirëmbajtje, shikoni manualin e përdorimit se si ta pastroni me një leckë të lagur ose fshesë me korrent.
	Sensori i ndotur/i bllokuar	<ul style="list-style-type: none"> • Sensori i grimcave është i lagësht. Lagështia në dhomën tuaj është shumë e lartë, duke shkaktuar kondensim. Kontrolloni që sensorin e grimcave të jetë i thatë dhe i pastër (shihni seksionin në manualin e përdorimit "Pastrimi dhe mirëmbajtja").

	Kushtet në dhomë	<ul style="list-style-type: none">• Dhoma në të cilën po përdorni pajisjen është më e madhe se sipërfaqja/vëllimi maksimal në të cilin kjo pajisje mund të funksionojë në mënyrë efektive. Sigurohuni që sipërfaqja e dhomës të mos kalojë madhësinë maksimale të treguar për modelin e pajisjes tuaj. Në këtë rast, rrisni shpejtësinë e ventilatorit në maksimum për të përmirësuar cilësinë e ajrit. Mbani në mend se pajisja do të ketë vështirësi të përballet me të gjithë vëllimin e ajrit sepse nuk është i përmasave për atë vëllim.• Nëse dritaret janë të hapura dhe ajri i ndotur ende hyn nga jashtë, pajisja juaj mund të mos jetë në gjendje të përmirësojë cilësinë e ajrit. Cilësia e ajrit të jashtëm është e dobët. Për performancë optimale të pastrimit, mbyllni dyert dhe dritaret kur përdorni pastruesin e ajrit.• Ka burime të ndotjes së ambienteve të brendshme, për shembull, pirja e duhanit, gatimi, shpërndarësit e temjanit
--	------------------	---

		<p>ose vajra, parfume, alkool ose prania e kafshëve shtëpiake. Kur shtoni mobilje të reja në një dhomë, cilësia e ajrit mund të ndikohet nga gazrat dhe grimcat e emetuara. Kjo duhet të zhduket gradualisht brenda disa javësh. Përndryshe, mund të keni lagështues që funksionojnë afër pajisjes, në të cilin rast sensori zbulon grimca të mëdha uji në ajër.</p>
Ngjyra e treguesit të pastërtisë së ajrit nuk ndryshon	Sensori i ndotur/i bllokuar	Sensori i grimcave është i ndotur. Pastrojeni sensorin e grimcave.
Pajisja prodhon aromë të çuditshme	Filtri i ri/filtri i përdorur	Herët e para që përdorni pajisjen, mund të lëshojë një erë plastike. Kjo është normale. Filtri mund të prodhojë një erë pas përdorimit të zgjatur për shkak të përthithjes së gazrave në hapësirën e mbyllur. Rekomandohet të riaktivizoni filtrin duke e vendosur në rrezet e diellit direkte për ripërdorim. Nëse aroma vazhdon, ndërrojeni filtrin.
	Mjedisi	Sigurohuni që të mos e përdorni pajisjen në zona me lagështi të lartë ose kur shpërndani vajra esencialë.
	Prishja	Nëse pajisja lëshon një erë djegieje edhe nëse hiqni filtrin, fiken pajisjen menjëherë dhe kontaktoni shitësin tuaj.
Pajisja është shumë e zhurmshme gjatë punës	Pajisja punon me shpejtësi të lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Është normale që pajisja të jetë më e zhurmshme nëse punon me shpejtësi të plotë në modalitetin manual. • Në modalitetin automatik, nëse pajisja është shumë e zhurmshme, është e mundur që pajisja të funksionojë me shpejtësi të lartë sepse cilësia e ajrit është e dobët. Mund të zgjidhni modalitetin e gjumit ose të zgjidhni një shpejtësi më të ulët në modalitetin manual.

	Brenda pajisjes ka objekte të huaja/pjesë të thyera	<ul style="list-style-type: none"> • Nëse diçka bie në kanalim e ajrit, mund të shkaktojë gjithashtu një zhurmë shumë të madhe. Fikeni menjëherë pajisjen dhe kthejeni përmbys për të hequr objektet e huaja. • Nëse pajisja është shumë e zhurmshme dhe keni kontrolluar gjithçka të përshkruar më sipër, kontaktoni shitësin tuaj.
Pajisja ende tregon se më duhet të zëvendësoj filtrin, por tashmë e kam bërë këtë.	Rivendosja e numëruesit të jetëgjatësisë së filtrit	Rivendosni numëruesin e jetëgjatësisë së filtrit duke shtypur gjatë butonin e filtrit për të paktën 3 sekonda.
Pajisja nuk kërkon nga unë të zëvendësoj filtrin dhe as të kryej veprë të mirëmbajtjes.	Nuk ka përdorim të shpeshtë / përdoret në situata ku cilësia e ajrit është e mirë.	Pajisja ju kujton të kontrolloni filtrin në varësi të sasisë së përdorur të pajisjes, si dhe faktorëve të tjerë si cilësia e ajrit në dhomën ku përdoret. Nëse nuk e përdorni shpesh pajisjen tuaj, do të duhet më shumë kohë që sinjalizimi të aktivizohet.
Sa gjatë mundet/guxon të punojë pajisja ime?	Info	Në përgjithësi, pajisja do të jetë më efikase kur dyert dhe dritaret janë të mbyllura. Rekomandohet që ta përdorni pajisjen ndërsa jeni në shtëpi për të ndihmuar në pastrimin e ajrit. Mund ta përdorni pajisjen tuaj 24 orë në ditë.
Si të porosis në filtër të ri?	Distribuimi / Shitja	Numrin për porosinë e filtrit mund ta gjeni në paketimin e pajisjes. Për të blerë një filtër, kontaktoni shitësin tuaj.
Nuk e kam dokumentacionin brenda paketës / Kam humbur manualin e përdorimit të pajisjes sime	Gabim në paketimin e produktit ose dokumentacioni i humbur.	Vizitoni www.aparatiko.mk dhe aty mund ta merrni dokumentin.